

E.S Financial Advisory shpk
Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR
Licensa Nr.260, Date 27.08.2012
Adresa: Rruga Tefta Tashko Koço, Pall 132, Ap 1, Tirane
Mob. 0696002295
e-mail: erjons@gmail.com

Tiranë, më 23.08.2024

Lënda: **Informacion në lidhje me mosrealizimin e shërbimit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë viti kalendarik 2023 për Partia Komuniste e Shqiperise**

Për: **Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve**
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin nr. 68, datë 5.7.2024, i KSHZ, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjekteve zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, i ndryshuar, jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2023 për 12 (dymbëdhjetë) Parti Politike, midis të cilave ishte dhe **Partia Komuniste e Shqiperise**.

Menjëherë pas lidhjes së kontratës me **KQZ-në**, më datë 27.07.2024, kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me **Partia e Komuniste e Shqiperise** për fillimin e procedurave të auditimit, fillimisht nëpërmjet dërgimit të shkresës për fillimin e procedurave të auditimit në adresën zyrtare me postë. Ne derguam gjithashtu kete shkrese dhe me email, ne emailin e financierit te deklaruar te subjektit politik dhe jemi ne pritje te nje pergjigjeje. Nga pergjigjja qe morem me email ne date 23/8/2024 (sot) finciari deklaroi se partia nuk ka patur fonde nga asnje burim te ardhurash, nuk ka realizuar asnje blerje mallrash e sherbimesh, nuk ka asnje te punesuar dhe nuk ka llogari bankare ne bankat qe veprojne ne Shqiperi dhe jashte saj (bashkangjitur deklarata, datuar 31.1.2024). Ne keto kushte subjekti ka dorezuar pasqyrat fiannciare me 0 ne KQZ – sic deklaruar nga subjekti.

Ne identifikuam nje raport financiar te dorezuar nga subjekti dhe jemi ne pritje te pergjigjeve per pyetjet qe kemi bere per kete raport. Ky eshte statusi i auditimit deri me tani per kete subjekt.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

E.S Financial Advisory shpk
Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR



31.01.2024

Deklarimet e Partisë Komuniste të Shqipërisë

Për audituesen Ligjore : Zj. Silvana Gjikhima

Kjo letër e deklarimeve jepet në përgjigje të kërkeses tuaj për informacion në lidhje me kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e datës 14/05/2023 nga Partia Komuniste e Shqipërisë, autorizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Lidhur me informacionin e kërkuar nga ana juaj, unë, kryetar i kësaj partie, deklaroj me përgjegjësi të plotë se Partia Komuniste e Shqipërisë gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e datës 14/05/2023:

- Nuk ka patur hyrje nga asnjë burim të ardhurash, si kuotat e antarësise, financime nga buxheti i shtetit, financime nga donatore të huaja dhe vendas, hua, burime në natyrë apo kompesime shpenzimesh.
- Nuk ka realizuar asnjë blerje mallrash e shërbimesh për llogari të partisë nga operatorë tregtarë dhe individ dhe nuk kemi bërë pagesa ndaj tyre.
- Nuk ka pasur të punësuar dhe për rrjedhim shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore.
- Nuk ka kontrata për ambiente me qera apo huapërdorje.
- Nuk ka të hapur asnjë llogari bankare në bankat që veprojnë në Shqipëri dhe jashtë saj.

Në kushtet e mungesës së transaksioneve ekonomike dhe financiare në kemi dorëzuar Pasqyrat Financiare me vlerë zero që kërkojnë nga KQZ-ja.

Konfirmoj vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në këtë dokument.

Për Partinë Komuniste të Shqipërisë

Kryetari:

Qemal Cicolari

